VENDIM
Nr. 150, datë 30.12.2013

MBI PROKURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR MBULIMIN E HUMBJEVE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

Në mbështetje të pikës 4.8, të "Modelit të tregut", miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 338, datë 19.3.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.12.2013, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike, lidhur mbi përgjegjësinë e OSSH sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes,

konstatoi se:

- OSSH sh.a. është përgjegjëse për importin e energjisë elektrike për të mbuluar të gjitha humbjet në sistemin e shpërndarjes;
- Kompania është vendosur në administrim të përkohshëm, sipas nenit 18, pika 4, germa "c", të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike";
- Humbjet faktike në sistemin e shpërndarjes përllogariten rreth datës 14 të muajit pasardhës, që shkakton një mospërputhje me planifikimit vjetor dhe humbjeve faktike në sistem.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve i ERE-s

VENDOSI:

1. "CEZ Shpërndarje" sh.a., në administrim të përkohshëm, për nevoja të mbulimit të plotë të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të realizojë blerjet e energjisë elektrike mbi baza mujore, për sasinë e energjisë elektrike që nuk mbulohet nga prokurimi vjetor.
2. "CEZ Shpërndarje" sh.a., për prokurimin e energjisë elektrike mbi bazë mujore, duhet të zbatojë procedurat e përcaktuara në "Rregulloren e prokurimit të energjisë elektrike", nga ana e OSSH sh.a., miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr. 42, datë 25.5.2009.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë OSSH sh.a për vendimmarrjen e ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti